

MIRËQEVERISJA

Përmbledhje e eseve të përgatitura nga pjesëmarrës
të Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike



Suplement i raportit vjetor 2011-2012

Kjo përmbledhje është botim i
Akademisë së Studimeve Politike
dhe financohet nga
Këshilli i Evropës dhe
Zyra e Bashkëpunimit
Zviceran në Shqipëri





Përshëndetja e "mentorit"

"Me gjeneratën e 2012-ës në Shkollën e Studimeve Politike diskutuar dhe dhamë përgjigje për pyetjet që kanë lidhje me konceptin e mirëqeverisjes. Jam i bindur se në esetë që ju do të lexoni në vijim do të vini re se kjo gjenerata e mori tepër seriozisht trajtimin e këtij koncepti. Ata u përpoqën që njohuritë e marra gjatë leksioneve dhe diskutimeve t'i përballin me përvojat e tyre profesionale për të krijuar raporte të atilla që sjellin fenomenet e zhvillimit politik-ekonomik në Shqipëri përballë zhvillimeve teorike në fushën e qeverisjes.

Koncepti i mirëqeverisjes është i pozicionuar fare mirë teorikisht dhe promovohet fort nga ndërkombëtarët si vaksina më efikase për të krijuar kushte për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik-social dhe për të luftuar korrupsionin. Kur koncepti lokalizohet në një truall si ky i Shqipërisë pas-tranzicionale të fillim shekullit XXI, rezultati del i qartë në esetë e përgatitura nga gjenerata e vitit 2012, të cilat synojnë një zbrëthim të elementeve të ndryshme të mirëqeverisjes, hetim akademik dhe analitik të tyre, si edhe konkluzione fort të moderuara e të pranueshme për të përmirësuar proceset që kanë lidhje me zhvillimin politik në Shqipëri.

Ia vlen shumë që të lexohet ky zë i moderuar, i cili vjen te ju me sigurinë e marrë nga studimi në shkollën shqiptare të politikës dhe maturinë e ushqyer nga grupi par excellence i lektorëve të shkollës. Theksoj me bindje të plotë dhe me aspak modesti se produkti i këtyre eseve përbën një start të shkëlqyer për politika publike, të cilat çdo politikëbërës në Shqipëri apo çdo parlamentar mund t'i përdorte për të zhvilluar e përmirësuar më tej nisma ligjore që do ta bënin shumë më efektive qeverisjen në Shqipëri.

Shqipëria është shumë e lodhur nga politika partiake e cila shpesh herë e vë në plan të dytë apo në mbështetje të interesave partiake apo të udhëheqësisë së saj zhvillimin politik dhe ekonomik kombëtar. Këta të fundit harrojnë shpesh here edhe ligjet që kanë miratuar vetë e har-

rojnë ose përpiqen të harrojnë se Shqipëria është mbi ta. Gjenerata e vitit 2012 me esetë e prodhuara tregoi shumë qartë se në Shqipëri zëri që mund të tingëllojë mbi ndarjet partiake dhe që vë shqiptaren mbi partiaken ekziston dhe mund të ushtojë pa bujë e me profesionalizëm.

Kemi një detyrë të vogël që kjo gjeneratë nuk arriti ta përfundojë: gjetjen e përforcuesit të këtij zëri me qëllim ndikimin e veshëve të shurdhuar nga interesat partiake. Shpresojmë që dhe ju si lexues të na bashkoheni në këtë detyrë e të na ndihmoni në shtimin e volumit të këtij lloji zëri që nxit mirëqeverisjen për të mirën e Shqipërisë.

Bernard Zeneli,

Anëtar i Bordit Drejtues

dhe përgjegjës për zhvillimin e plan programeve akademike

Hyrje

Me përfundimin e ciklit të programit të shkollës, pjesëmarrësit duhet të paraqisnin një ese përfundimtare për një temë të zgjedhur prej tyre, që kishte lidhje me tematikat e programit.

Për vitin 2012 u identifikuan dhe u propozuan tri tema madhore e me spektër të gjerë:

- Politikat e zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri;
- Institucionet dhe demokracia funksionale në Shqipëri;
- Partitë politike dhe zgjedhjet në Shqipëri;

Esetë e pjesëmarrësve përbëjnë mjete të rëndësishme kërkimore që mund të përdoren nga vetë ata apo alumnit e ASPS-së në diskutime publike dhe nisma avokuese në fushat e tyre të interesit. Në vitin 2012 u përzgjedhën nëntë ese si pjesë e koleksionit të eseve për qeverisjen e mirë, përmbledhjen e të cilave ju ftojmë ta ndiqni në këtë botim special të Akademisë së Studimeve Politike. Materialet e plota mund të gjenen pranë Akademisë së Studimeve Politike dhe mund të përdoren si referenca në punime të tjera didaktike apo shkencore duke respektuar të drejtën e autorit.

Përmbajtja

Përshëndetja e “mentorit”	3
Hyrje	5
Mirela Karapici Roli i medias dhe i shoqërisë civile në procesin politikëbërës. A është media ajo që e çon përpara shoqërinë civile apo të dyja qëndrojnë në të njëjtin front gjatë këtij procesi?	7
Ervina Domi Lufta kundër korrupsionit përballë përgjegjshmërisë qeverisëse dhe përgjegjshmërisë së administratës doganore shqiptare	9
Ilir Korbi Komunikimi politik në web: Fushatat zgjedhore në kohën e internetit.....	11
Jorina Gjinari Qeverisja e mirë dhe Shoqëria Civile.....	13
Eva Dauti Koncepti i mirëqeverisjes në kontekstin e zhvillimit ekonomik dhe social.....	15
Baisa Sefa Premisa e integritimit evropian dhe impakti i saj në konsolidimin e demokracisë në Shqipëri	17
Albana Shtylla E drejta për informim, zbatim nga organet e administratës publike në Shqipëri, element i rëndësishëm i transparencës së veprimtarisë së tyre.....	19
Margarita Kola Lidhja konceptuale ndërmjet të drejtave të njeriut dhe mirëqeverisjes	21

Tema: Roli i medias dhe i shoqërisë civile në procesin politikëbërës. A është media ajo që e çon përpara shoqërinë civile apo të dyja qëndrojnë në të njëjtin front gjatë këtij procesi?

Punoi: Mirela Karapici

Për më shumë se dy dekada nga rënia e komunizmit shoqëria civile shqiptare manifeston karakteristikat e një sektori mesatarisht të zhvilluar, i cili vepron në një mjedis relativisht të ndikuar nga politika dhe politikëbërësit, ndërkohë që roli i medias është pothuajse i padukshëm në këtë proces.

Media dhe shoqëria civile janë dy aktorë që ndikojnë pozitivisht në politikëbërjen dhe mirëqeverisjen, pasi me reagimin e tyre të drejt-përdrejtë ndikojnë në vendimmarrje, proces ky mjaft i rëndësishëm në jetën e një vendi.

Media jep ndihmesë të rëndësishme jo vetëm për orientimin e mendimeve politike të njerëzve, për kultivimin e vetëdijes së tyre qytetare, por edhe për kontrollin e anëve të ndryshme të organeve shtetërore. Jo më kot ajo quhet edhe pushteti i katërt.

Nëpërmjet një analize krahasuese, në këtë temë trajtohen roli dhe kontributi që kanë dhënë media dhe shoqëria civile në procesin politikëbërës, duke i vene ato përballë njëra tjetrës për të kuptuar nëse është media që e çon përpara shoqërinë civile apo e kundërta.

Në dy dekadat e fundit shoqëria civile në Shqipëri ka shënuar progres të konsiderueshëm në lidhje me zhvillimin e vet dhe kontributin e ofruar në adresimin e sfidave të shoqërisë postkomuniste. Duke e vështruar këtë proces nga perspektiva e zhvillimit të shoqërisë civile, identifikimi i sfidave aktuale dhe i së ardhmes u imponua, veçanërisht në vitet e fundit, domosdoshmëria për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të shoqërisë.

Prirja në rritje e një qëndrimi kritik ndaj vetes tek aktorët e shoqërisë civile në Shqipëri, pritshmëri më të larta për rolin e saj, si edhe zhvendosja e fokusit të diskutimit publik nga ajo se “çfarë duan donatorët” drejt “çfarë presin aktorët vendorë prej shoqërisë civile” përfaqësojnë shenja të qarta të maturisë së qëndrimit të aktorëve kryesorë të shoqërisë.

Në përmbledhje të materialeve dhe diskutimeve për nismat e shoqërisë civile, aktivizimin dhe përfshirjen qytetare në to, raportit të indeksit të shoqërisë civile, raporteve të Freedom House për lirinë e shtypit dhe të mediave, dhe sensibilizimi mediatik i shtetit për problemet e mjedisit, rezulton se shoqëria civile është ndeshur me problematika të ndryshme, duke filluar nga sensibilizimi i popullatës nëpërmjet fushatave mediatike, nënshkrimit të referendumeve, protestave paqësore, të cilat kanë çuar në zgjidhjen më optimale të këtyre çështjeve.

Në përfundim rekomandohet përfshirja e qytetareve në organizatat shoqërore dhe shoqërinë civile duhet të jetë më e gjerë dhe më aktive, pasi vihet re një përqindje shumë e ulët e pjesëmarrjes qytetare në to. Pjesëmarrja vullnetare e qytetareve në shoqërinë civile dhe në organizime politike e mediatike për sensibilizimin e tyre duhet të jete më lartë dhe gjithëpërfshirëse nga të gjitha shtresat dhe grupmoshat e shoqërisë.

Tema: Lufta kundër korrupsionit përballë përgjegjshmërisë qeverisëse dhe përgjegjshmërisë së administratës doganore shqiptare

Punoi: Ervina Domi

Lufta kundër korrupsionit padyshim që kërkon përgjegjshmëri qeverisëse, e njëkohësisht, edhe përgjegjshmërinë institucionale të administratës.

Në mungesë të mirëqeverisjes, pra në kushtet e reformave të njëanshme, të pastuduara, të izoluara, që nuk mund të garantojnë efikasitet dhe efektivitet, në mungesë të zbatimit të ligjit etj., pra në mungesë të përgjegjshmërisë qeveritare, apo dhe në mungesë të shtetit të drejtës, lufta kundër korrupsionit nuk mund të realizohet edhe pse mund të jetë një dëshirë politike apo një detyrim i vendosur nga Evropa. Kjo luftë duhet mbështetur në mirëqeverisje e reforma të plota, eficiente e efektive, përmes një sistemi e cikli analitik reformash, bazuar në nevojat reale të palëve të përfshira në proces (legjislativi, ekzekutivi, gjyqësori etj.), të cilat, padyshim, do të pasoheshin nga përgjegjshmëria institucionale, si një tregues tjetër i mirëqeverisjes.

Vlerësoj se suksesi në luftën ndaj korrupsionit është më i garantuar, nëse reformat qeveritare do të bashkëshoqëroheshin me reforma rregullatore, me synim reduktimin apo shuarjen e gjithë treguesve, që shërbejnë si premisë për korrupsion, që ndikojnë drejtpërdrejtë në të ardhurat e buxhetit e shtetit, në tkurrjen e evazionit fiskal por paralelisht edhe në rritjen e mirëqenies, të sigurisë e qëndrueshmërisë së vetë individit. Sa kohë që mirëqeverisja kërkon ndër të tjera efikasitet dhe efektshmëri po ashtu edhe përgjegjshmëri, lidhja ndërmjet këtyre treguesve është e domosdoshme dhe mungesa e njërit prej tyre do të cenonte mirëqeverisjen.

Pavarësisht nga reformat e shumta të ndërmarra në vite dhe nga ulja reale e nivelit të korrupsionit, hartimi dhe zbatimi i plotë i një cikli

reformash rregullatore, shumëplanëshe dhe ndërinstytucionale për një sistem organik ndërlidhës funksionesh e pushtetesh, funksional, efektiv dhe eficient, që të reflektojë qartazi përgjegjshmëri qeverisëse e përgjigjshmëri ndërinstytucionale, do të ishin premisa tepër pozitive në luftën ndaj korrupsionit në vend.

Tema: Komunikimi politik në web: Fushatat zgjedhore në kohën e internetit

Punoi: Ilir Korbi

Në vitet e fundit roli dhe ndikimi i internetit ka ardhur duke u rritur. Përdorimi i tij në fushatat politike ka evoluar në vazhdimësi gjatë këtyre 20 viteve. Dikur fushatat zgjedhore në Shqipëri mbështeteshin tek fjalimet, tubimet, gazetatat, radio, televizori, ndërsa sot, një ndër aspektet karakterizuese të fushatave zgjedhore është përdorimi i mediave sociale, si Facebook dhe Twitter. Këto mënyra komunikimi sollën risinë për qytetarët për një pjesëmarrjen aktive në jetën politike. Nëpërmjet internetit informacioni qarkullon me shpejtësi. Fansat e një subjekti politik ose një partie “ndajnë” me miqtë e tyre lajmin e publikuar në një faqe web-i, e në këtë mënyrë lajmi bën një xhiro rreth botës në fare pak sekonda. Përdorimi i internetit në Shqipëri ishte çelësi i suksesit në garën për kandidatin për Bashkinë e Tiranës.

Kandidati i Partisë Demokratike z. Lulzim Basha, përdori së bashku me ekipin e vet internetin në një shkallë të paarritur më parë. Për herë të parë z.Basha zhvilloi një komunikim virtual me fansat e vet, ku i drejtoheshin pyetje dhe në pikun e tij, këtë komunikim e ndiqnin mbi 2000 persona pjesëmarrës “live”. Fushata zgjedhore për kandidatin e Bashkisë të Tiranës ishte shumë pozitive dhe frutdhënëse, nxiste shumë ide të reja dhe mbi të gjitha shfaqti suksesin e interesit të rinisë në pjesëmarrjen politike.

Vlen të përmendet fakti që gjatë kësaj fushate nuk munguan edhe mënyrat joqytetare të përdorimit të mjetit më të rëndësishëm të këtyre kohërave. Si rrjedhim i këtyre sjelljeve u evidentua rezultati jo i këndshëm i deformimit të thelbit të fushatës zgjedhore apo të integritetit të vetë kandidatëve. Keqpërdorimi i teknologjisë shpesh herë bëri të mundur kalimin e mitingut nga sheshe në internet, duke krijuar shfaqje amatoreske të kronikave propagandiste të lajmeve, të shoqëruara

me ulërime mbështetëse nga militantët, si dhe me fyerje e akuza ndaj kundërshtarëve politikë.

Për të arritur nivele sa më të larta demokratike në zgjedhjet e ardhshme duhet të realizohet një komunikim përmes rrjeteve sociale, i cili të sjellë shkëmbim idesh, argumente programore, sugjerime pozitive për zgjidhjen e problemeve, si dhe parashtrimin të tematikave të ndryshme.

Tema: Qeverisja e mirë dhe Shoqëria Civile

Punoi: Jorina Gjinari

Më 19 nëntor 1663, Abraham Linkoln përmendi për herë të parë në fjalimin e tij në Gettysburg, atë që është bërë sot një nga përkufizimet më të pranuar të një qeverie demokratike: “Qeveria e popullit, nga populli, për popullin”. Në të vërtetë, një nga aspektet më të rëndësishme të një qeverie demokratike është shoqëria civile, e cila shërben si një mekanizëm mbikëqyrës mbi veprimet e qeverisë për të promovuar qeverisjen e mirë, në anën tjetër, qeverisja e mirë në vetvete lejon zhvillimin e shoqërisë civile.

Sa i përket rastit të Shqipërisë, demonstratat studentore të viteve 1990, të cilat sollën rrëzimin e regjimit komunist, mbeten sot e kësaj dite një nga shembujt më të njohur se si shoqëria civile mund të ndikojë në ndryshimin dhe njëkohësisht të kërkojë një qeverisje më të mirë. Megjithatë, me kalimin e viteve, duket se ndikimi i shoqërisë civile shqiptare është kufizuar në mënyrë të konsiderueshme, pavarësisht rritjes së numrit të aktorëve që veprojnë në këtë fushë. Në fakt, shoqëria civile në Shqipëri konsiderohet të jetë e pazhvilluar, dhe sipas mendimit tim, një nga mangësitë kryesore të shoqërisë civile shqiptare është mungesa e “think tanke-ve” apo mekanizmave të tjera të ngjashme, të cilat mundësojnë që elitat intelektuale dhe profesionistët të kontribuojnë në debatet e politikës dhe njëherazi edhe në ndryshimin e pritur.

Në të gjitha shoqëritë demokratike, institucionet “think tank” janë kanali kryesor i ndikimit të elitave intelektuale dhe ekspertëve. Këto organizma kanë një rol tepër të rëndësishëm pasi ato zhvillojnë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me autoritetet qeveritare dhe institucionet përkatëse. Nëpërmjet këtij aksesit të afërt me organet vendimmarrëse, këto organizma shërbejnë edhe si një mekanizëm për të legjitimuar vullnetin e opinionin publik, por sigurisht edhe si një filtër kontrol-

li për nismat që vetë institucionet publike i transmetojnë publikut të gjerë.

Një nga shembujt më flagrante të apatisë së ekspertizës profesionale përkundër procesit të reformave të ndërmarra në vendin tonë është edhe reforma e arsimit shqiptar, përfshirja në të ashtuquajturin “sistemi i Bolonjës”. Shqipëria ka një eksperiencë të gjatë me reformat moderne, por njëkohësisht edhe me vështirësinë e zbatimit të tyre në praktikë. Edhe ky proces i “sistemit të Bolonjës” ka ngjallur deri më sot disa probleme dhe shqetësime, të cilat janë shprehur publikisht si nga profesorët ashtu edhe nga studentët. Megjithatë, asnjë nga ekspertët, të cilët kanë nënvizuar problematikën e kësaj reforme, nuk kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm që zëri i tyre të dëgjohet. Nuk është prezantuar deri më sot asnjë studim shkencor, analizë akademike apo studim krahasues, i cili mund të tentonte hulumtimin e procesit të reformës dhe ndikimin e saj në sistemin arsimor. Është evidente pra, mungesa e një debati konstruktiv dhe gjithashtu një hezitim i elitës intelektuale për t’u përfshirë në një nismë të tillë. Për fat të keq ky nuk është një rast i izoluar dhe ashtu si edhe në raste të tjera, kjo mungesë e debatit midis autoriteteve zyrtare dhe publikut mund të rezultojë e dëmshme për procesin e reformës.

Përkundër vështirësive të shumta me të cilat duhet të përballet shoqëria civile shqiptare, duhet të nënvizohet se situata aktuale në të cilat ndodhet Shqipëria janë të favorshme për pozitën e saj. Aspiratat e Shqipërisë për t’u bërë anëtare e Bashkimit Evropian përkthehen në një presion të vazhdueshëm për përmbushjen e kriterëve të BE-së, njëri prej të cilëve është edhe qeverisja e mirë. Ky parim, në vetvete, është i bashkëshoqëruar me nevojën për një mbështetje të vazhdueshme të shoqërisë civile. Është e kuptueshme pra, se qeveria shqiptare do të jetë vazhdimisht nën mbikëqyrjen dhe presionin e institucioneve ndërkombëtare për të përmbushur kriteret e përmendura më sipër dhe si rrjedhojë zëri i shoqërisë civile do të jetë i domosdoshëm. Tashmë, është shoqëria civile ajo që duhet të shfrytëzojë më mirë këtë avantazh të krijuar dhe të kërkojë mbështetje nga këto organizata të presionit ndaj qeverisë, për të adresuar më mirë dhe bindshëm shqetësimet e opinionit publik.

Tema: Koncepti i mirëqeverisjes në kontekstin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror

Punoi: Eva Dauti

Nën konceptin e parimeve të mirëqeverisjes e në kontekstin e zhvillimeve aktuale social ekonomike, esesa është një reflektim mbi bazat e zbatimit në praktikë të këtyre koncepteve dhe rolit që individi merr në pajtimin ose jo me këto parime.

Një shoqëri demokratike, është një shoqëri që njeh dhe respekton te drejtat dhe liritë themelore të individit. Këto të drejta shprehen dhe garantohen nga akti themelor i shtetit, Kushtetuta, dhe hierarkia e ligjeve që burojnë prej saj. Ushtrimi i pushtetit në shoqërinë demokratike jo vetëm që ka karakter normativ dhe institucional, por mbart disa vlera dhe parime që e shndërrojnë atë në një shoqëri funksionale e të materializuar nga disa faktorë të qenësishëm. Këta faktorë janë ndërlidhësit e qeverisjes së mirë, asaj transparente, të përgjegjshme, efiçente, efektive dhe pjesëmarrëse.

Një rol thelbësor në ushtrimin praktik të koncepteve teorike të mirëqeverisjes ia kam atribuar individit reformues, aktiv dhe vendimmarrës. Individu, i cili, i “veshur” nga fryma e ndryshimit ushtron ndikimin e tij në shoqërinë dhe komunitetin që përfaqëson, duke besuar realisht në ndërtimin e një shoqërie ku ligji është i barabartë për të gjithë e ku piramida institucionale drejtohet nga liderë të besueshëm, të vërtetë e me vizion. Përballë tij kam vendosur edhe individin vendor të urbanizuar, i cili shpreh pasivitetin, agresivitetin dhe trajta sipërfaqësore, aspak vendimmarrës në fillimin e politikave publike, dhe i paftë për të ndryshuar dhe mbrojtur interesat e qytetarëve që përfaqëson. Gjatë periudhës së tranzicionit, individi shqiptar është përballur me një realitet tërësisht të ri social, ekonomik dhe urban, i karakterizuar nga sfida dhe mundësi të shumta. Këto zhvillime evidentuan nevojën për të zhvilluar dhe forcuar, në mënyrë të menjëhershme, një paradigmë

të re të qeverisjes së mirë në nivel vendor, me një pronësi konkrete, angazhim qytetar dhe me orientim nga kërkesa.

Tema: Premisa e integrimit evropian dhe impakti i saj në konsolidimin e demokracisë në Shqipëri

Punoi: Baisa Sefa

Ndonëse integrimi evropian është një çështje e lakuar gjerësisht, ajo sërish mbetet kontraversale për sa u përket implikimeve që prodhon te vendet aspirante. Perspektiva e integrimit evropian ka qenë dhe vazhdon të mbetet një proces transformimi holistik, fillimisht për Evropën Qendrore e Lindore (EQL) dhe tashmë edhe për Ballkanin Perëndimor (BP).

Shembujt nga zgjerimi më i madh që ka përjetuar BE-ja kanë vënë në dyshim fuqinë transformuese të vetë kësaj strukture. Situata problematike në Hungari lidhur me ndryshimet regresiste kushtetuese është rasti më tipik që hedh hije të fortë dyshimi nëse anëtarësimi në BE prodhon një standard fiktiv demokratik. Ky dyshim rritet nëse i referohemi situatës aktuale që po përjetojnë disa prej shteteve anëtare të saj. Por a është integrimi evropian një proces kaq thelbësor transformimi sa propagandohet?

Në rastin e Shqipërisë ëndrra evropiane ka filluar që me thirrjet “E duam Shqipërinë si e gjithë Evropa”, ku dëshirat dhe aspiratat e një populli të sapo dalë nga regjimi komunist orientoheshin drejt një bashkësie demokratike. Kriteret politike për anëtarësimin në BE janë standarde të pjekurisë demokratike dhe në thelbin e tyre lidhen ngushtë me idenë e shtet-formimit të Fukuyamës. Ndaj integrimi evropian i Shqipërisë i shërben konsolidimit të demokracisë dhe shtet-ndërtimit. Në këtë kontekst, perceptimi i integrimit evropian si një proces i udhëhequr së ‘jashtmi’ ka nevojë të rikonfigurohet për të kuptuar që ai nuk është qëllim në vetvete, por produkt i një proces, që buron së brendshmi me kontributin e të gjithë aktorëve vendorë.

Anëtarësimi paraqitet si garanci më shumë për të kontrolluar dhe kufizuar papërgjegjshmërinë e elitës politike vendore, e cila pa

mbikëqyrjen e BE e ka të vështirë respektimin e normave demokratike. Në rastin e Shqipërisë ka një kontradiktë ndërmjet mënyrës sesi është konceptuar procesi i integritimit nga BE-ja dhe mënyrës se si ky proces përdoret, manipulohet apo abuzohet nga elitat politike. Kjo kontradiktë ka bërë që integrimi evropian jo vetëm të mos i shërbej forcimit të demokracisë, por të prodhojë deri diku një sistem hibrido-demokratik, që nuk mund të mbijetojë pa ndihmën e ndërkombëtarëve. Aktualisht është e artikuluar nga të gjitha forcat politike perspektiva evropiane e Shqipërisë, aq sa kuadri i përparësive të integritimit shërben si mburojë justifikuese për manipulime politike. Një konformizëm i tillë e ul intensitetin e debatit politik duke e thjeshtëzuar diskutimin tek ritmi dhe mënyra për ta arritur atë, duke shmangur debatin për modelet e zhvillimit që duhet të adoptojmë. Mungesa e këtij debatit dhe alternativave politike i ka zhgënjyer qytetarët e për rrjedhojë, ka sjellë deri diku de legjitimimin e partive politike. Sa më shumë që qytetarët zhgënjehen nga politika, aq më shumë ata e kërkojnë shpëtimin tek BE-ja.

Kësisoj, rrugëtimi i Shqipërisë në përmbushjen e 12 përparësive është rrugëtim drejt ndërtimit të një shteti demokratik të konsoliduar. Ndonëse trajektorja e tij nuk është aspak e njëtrajtshme, duhet theksuar se presioni i integritimit evropian e ka udhëhequr Shqipërinë drejt shndërrimeve të rëndësishme demokratike. A do të kishin ndodhur po të njëjtat shndërrime në kushtet e mungesës së presionit që ushtron integrimi evropian te elitat politike dhe opinioni publik? Logjika lipset të thotë se rrota e zhvillimit e ka të domosdoshme praninë e forcave shtytëse.

Tema: E drejta për informim dhe zbatimi nga organet e administratës publike në Shqipëri, element i rëndësishëm i transparencës së veprimtarisë së tyre

Punoi: Albana Shtylla - *Doktorante*

Konteksti në të cilin gjendet shoqëria shqiptare në kuadër të procesit të integritetit në BE paraqet si kërkesë të natyrshme që veprimtaria e organeve të administratës publike të fokusohet në zbatimin e standardeve të larta të mirëqeverisjes, miradministrimit dhe transparencës. Për të garantuar këto standarde, legjislacioni shqiptar dhe zbatimi i tij, duhet të jenë të përqasur me përcaktimet kushtetuese dhe të akteve ndërkombëtare, duke kontribuar, në këtë mënyrë në zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, bazuar në parimet demokratike të shtetit të së drejtës.

Në tërësinë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, e drejta e publikut për t'u informuar për veprimtarinë e organeve të administratës publike në Shqipëri, është një e drejtë kushtetuese tepër e rëndësishme për garantimin e transparencës nga organet e administratës publike. Si rrjedhojë, me realizimin e së drejtës së informimit në praktikë, rritet besimi i qytetarëve për veprimtarinë e administratës, duke ndihmuar në këtë mënyrë në suksesin e politikave administrative. Nëpërmjet këtij punimi, është bërë një vlerësim sesa zbatohet nga organet e administratës publike detyrimi ligjor për garantimin e të drejtës së informimit së çdo individit, dhe cilat janë problematikat e konstatuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit për këtë çështje.

Në përfundim të kësaj analize, është arritur në konkluzionin se për garantimin e së drejtës për informim dhe më tej të transparencës në administratën publike është e rëndësishme që:

a) Së pari, nëpërmjet rregullave të mirëpërcaktuara dhe të qarta në legjislacion për të drejtën e informimit, të garantohet mirëfunksionimi dhe transparenca e organeve të administratës publike në veprim-

tarinë e saj të përditshme, si ndaj publikut të gjerë, edhe me politikat që ndërmerren.

b)Së dyti, organet e administratës publike, në të gjitha nivelet, duhet të zbatojnë detyrimin ligjor për të pranuar e trajtuar me seriozitet të gjitha ankesat e qytetarëve, duke krijuar për këtë qëllim procedura dhe struktura në përputhje me ligjin dhe funksionale për garantimin e së drejtës për informim.

c)Së treti, organet dhe autoritetet e administratës publike në veprimtarinë e tyre t'i përmbahen respektimit të parimit të transparencës, në funksion të një qeverisjeje sa më të hapur me publikun.

ç)Së katërti, organet e pushtetit vendor dhe autoritetet shtetërore në nivel vendor, pranë të cilave përfitohet edhe pjesa më e madhe e shërbimeve, të trajnohen dhe formohen në mënyrë të vazhdueshme për dispozitat e legjislacionit në fuqi për të drejtën për informim.

d)Së fundmi, vendosja dhe zbatimi i sanksioneve ndaj organeve publike, që shkelin dispozitat e ligjit, ndikon në zbatimin e garantimin e së drejtës së individit për informim.

Mbështetur në analizën e këtij punimi, por edhe në përfundimet e sipërpërmendura mund të themi se transparenca dhe garantimi i plotë i saj nga organet e administratës publike nuk është një angazhim i thjeshtë, por, për realizimin e tyre kërkohet një ndërveprim faktorësh dhe aktorësh.

Tema: Lidhja konceptuale ndërmjet të drejtave të njeriut dhe mirëqeverisjes; Rast studimor: qeverisja e decentralizuar në Shqipëri dhe zhvillimi i përqasur sipas të drejtave të njeriut

Punoi: Margarita Kola

Në analizën e rastit studimor nuk është ndërmarrë ndonjë hulumtim i drejtpërdrejtë në terren, por u jemi referuar evidencave e konkluzioneve të nxjerra nga vëzhgimet dhe vlerësimi i drejtpërdrejtë në terren i mbarëvajtjes, si dhe praktikave të zbatimit të reformës decentralizuese në Shqipëri nga organizata ndërkombëtare e vendore, që punojnë deri në nivel vendor.

Decentralizimi në Shqipëri: A është kjo rruga që, domosdoshmërisht, siguron zbatimin e së drejtës për zhvillim dhe, si rrjedhojë, respektimin e të drejtave të njeriut?

Reforma për decentralizimin e pushtetit vendor, e ndërmarrë nga qeveria shqiptare, ka qenë njëra prej reformave shumë të diskutuara dhe shumë të mbështetura edhe nga faktori ndërkombëtar dhe ka nënkuptuar delegimin e përgjegjësive, vendimmarrëse dhe menaxhuese, nga pushteti qendror pushtetit vendor, për një zhvillim më të mirë rajonal dhe menaxhim më të mirë të taksave vendore. Pavarësisht treguesve pozitivë në drejtim të rritjes së përgjegjësive të pushtetit vendor, tabloja e sugjeruar nga raportet ose studimet nuk është e njëjtë kur flasim për zhvillim “të barabartë” ose “të njëtrajtshëm”, në nivel vendor.

Konkluzionet dhe sfidat

Ndërsa shpesh teorikisht argumentohet se mirëqeverisja është e dobishme jo vetëm si koncept por edhe përtej tij, për të siguruar garantimin e të drejtave të njeriut, në përgjithësi, dhe të drejtën për zhvillim, në veçanti, për të kuptuar se si modele të caktuara mirëqeverisëse, si ai

i decentralizimit, veprojnë në kontekste të caktuara shoqërore, sfera e debatit duhet të zhvendoset për të prekur çështje të cilat kanë të bëjnë me mënyrën se si modele të ndryshme mirëqeverisjeje mund të prodhojnë varësi të përmbysura kur vjen fjala te praktikiteti dhe aktualizimi i këtyre të drejtave.

Rasti i decentralizimit në Shqipëri sugjeron që decentralizimi si një model i qeverisjes së mirë në vetvete nuk është kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për të realizuar dhe aktualizuar të drejtën për zhvillim dhe, si rrjedhojë, të drejtat e njeriut në përgjithësi, përkundrazi, nënvizon dhe përforcon me shume gjasa të kundërtën e kësaj. Në vende të vogla si Shqipëria, ku nevoja për të përqafuar decentralizimin si një mjet për të siguruar vendimmarrjen sa më afër qytetarit, si dhe për dhënien llogari të vendimmarrësve po në këtë nivel peshon më pak se sa rreziqet që mbart decentralizimi, si rezultat i mungesës së mekanizmave kontrollues dhe i ekzistencës së pabarazisë rajonale duke rrezikuar objektivin thelbësor të vetë reformës decentralizuese për atë kohë sa reforma decentralizuese nuk shoqërohet me mekanizma kontrollues qofshin këta vertikal (pushtet qendror-pushtet vendor) apo horizontal (grupe interesi, OJF vendore-pushtet vendor).

Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike vepron që prej vitit 2007. Fokusi i saj janë politikanët e rinj, administratorët publikë dhe udhëheqësit e shoqërisë civile, të cilët shkëmbejnë eksperiencat dhe njohuritë dhe gjithashtu trajnohen në një numër fushash si: mirë-qeverisja në nivel qendror dhe vendor, politikat publike, komunikimi politik, politikat dhe legjislacionin e Bashkimit Europian si edhe përfshirjen e komuniteteve të nën-përfaqësuar në proceset politike.

Akademia e Studimeve Politike

Adresa: Kotroni Center,
Rr.Donika Kastrioti, Nr.3,
Kati 4, Zyra 2, Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 2272173
+355 4 4504788
Fax: +355 4 2272173
E-mail: info@asp.al
Web: <http://www.asp.al>

